



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.114/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtare, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Mitrovicë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Mitrovicë, për shkak të vendosjes së panos reklamuese në rrugë dhe hapësirë publike, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa ZL.Anr.114/2017 e datës 02.10.2017 e parashtruar nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega në Mitrovicë, me të cilën kërkohet që ti shqiptohet dënimi me gjobë subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Mitrovicë, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes.

A r s y e t i m

Me datën 02.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Aleanca Kosova e Re (AKR), me të cilën pretendon se me datën 02.10.2017, në sheshin Adem Jashari në Mitrovicë, subjekti politik PDK ka vendosur pano reklamuese të kryetarit dhe të anëtarëve të Kuvendit Komunal në Mitrovicë. Me propozim për panelin që të merren masa ndëshkuese ndaj subjektit politik PDK.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një fotografi të printuar lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 04.10.2017, subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), e konteston në tërësi ligjshmërinë e ankesës së ushtruar për arsye se vendi mënyra dhe dukja e panos reklamuese nuk është në kundërshtim me nenin 33 par.1 të LZP-së, dhe me asnjë dispozitë tjetër të LZP-së, dhe se për vendosjen e panos në kohë fushate si rregull nuk ka nevojë të kërkohet leja, kur është e lejuar publikimi i materialit për fushatë dhe atë në pajtim me dispozitat relevante të LZP. Me propozim për PZAP-in, që ankesa të refuzohet si e pabazuar dhe e pa lejuar.

Përgjigjes ia ka bashkangjitur një shkresë-pëlqim të përkohshëm më datë 06.10.2017 të lëshuar nga Komuna e Mitrovicës.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesë lidhur me shkeljen e pretenduar të Kodit të Mirësjelljes nga ana e subjektit politik PDK, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se, veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të Kodit të Mirësjelljes në kuptim të dispozitës së nenit 33 pika b) të LZP-së, për arsye se vendosja e panos reklamuese të kandidatit për kryetar dhe të anëtarëve për kuvend komunal nga subjekti politik PDK janë në vendin e dedikuar për vendosjen e tyre.


Nga arsyet e theksuar më lartë dhe duke u bazuar në nenin 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.114/2017 më datën 06.10.2017.

Kryesuesi i Panelit

Rafet Haxhaj



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.